



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOS.  
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTARËVE  
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 16285  
Br. 1  
Nr. i faq. 1  
Br. str. 1  
Data: 01.10.2025  
Datumi: 2025

Komuna e Kamenicës  
Opština Kamenica  
Kamenica Municipality



## Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.241, datë: 30.06.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (nr.03/L-040), nenit 81 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik, nenit 70, paragrafi 70.20 i Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik i nxjerr nga KRPP-ja, dhe nenit 61 paragrafi 61.17 dhe 61.21 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik i nxjerr nga KRPP-ja, Kontrata Sh.02.Nr.16091 e datës 27.06.2025, nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. **FORMOHET** ekipa për menaxhimin e kontratës dhe mbikqyrësin e kontratës në tenderin: **“Mirëmbajtja e terreneve të hapura dhe të mbyllura sportive dhe furnizimi me rekuizita sportive”** me numër identifikues të prokurimit: **KM653-25-3613-2-2-1**, me këtë përbërje:

1.1 **Besart Fejzullahu** (DUPH), Kryesues;

1.2 **Amire Ismajli** (Konsulente, Drejtorja për Investime Kapitale), anëtare; dhe

1.3 **Vlonë Matoshi** (Konsulente, Drejtorja për Investime Kapitale) anëtare.

Mbikqyrësi i drejtëpërdrejtë i ekipës për menaxhimin e kontratës:

1.4 **Sylejman Kallaba** (DUPH).

2. Ekipa për Menaxhimin e Kontratës e caktuar si në pikën një (1) të këtij Vendimi është përgjegjës për menaxhimin e kontratës specifike dhe për të informuar Zyrtarin e Prokurimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.
3. Ekipa për Menaxhimin e Kontratës obligohet të përgatitë planin për menaxhimin e kontratës duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja dhe brenda (2) dy ditëve të punës i dërgon një kopje të planit për menaxhimin e kontratës Zyrës së Prokurimit.
4. Pas pranimin të planit për menaxhimin e kontratës, Zyra e Prokurimit obligohet që t'i lëshojë Ekipës së Menaxhimit dokumentacionin e paraparë sipas Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik i nxjerr nga KRPP-ja.
5. Ekipa për Menaxhimin e Kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të punëve të kërkuara, përkatësisht deri në përmbylljen e kontratës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.


### T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Zyrës së Prokurimit;
- Anëtarëve të Ekipës, Mbikqyrësit; dhe
- QSHQ-arkiv.

Kryetari i Komunës  
**Kadri Rahimaj**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës  
Opština Kamenica  
Kamenica Municipality

## Zyra e Kryetarit

**Sh.02.Nr.243, datë:01.07.2025**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata Sh.02.Nr.16333 e datës 01.07.2025, nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

### VENDIM

#### Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **"Pastrimi i lumenjve dhe përrockave"**, me numër të kontratës **KM653-25-1640-2-1-1**, si në vijim:
  - 1.1. **z. Shaban Lenjani** (DSHPAIE), CAKTOHET menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
  - 1.2 **z. Besim Morina** (DSHPAIE), CAKTOHET mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

#### T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Shaban Lenjani (DSHPAIE);
- z. Besim Morina (DSHPAIE); dhe
- QSHQ-arkivi.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës  
Opština Kamenica  
Kamenica Municipality



## KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

KM653-25-1640-2-1-1/C703

QENDRA PËR SHËRBIMET E GJYKIMIT  
CENTAR ZA USLUGU GRABANA

Sh. 02 Nr. 16333  
U. Br.

faq. 13 Data: 21/07  
Br. str. Datum:  
KAMENICA 2025

KOMUNA E KAMENICËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë,  
dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik „VARNA SH.P.K.; Rinesa SH.P.K., katundi i ri, Kamenica, (në vazhdim  
"Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Pastrimi i lumenjëve dhe përrockave me numër identifikues: KM653-25-1640-2-1-1

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Sipas pershkrimit të çmimve dhe dosjes së tenderit

| Nr. | Grupi                               |
|-----|-------------------------------------|
| 1   | Pastrimi i lumenjëve dhe përrockave |

Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurorin shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 01.07.2025 dhe përfundon në datën 31.06.2027

### Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 10 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Sipas kërkesave të njësisë kerkuese

### Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është 150,000.00 Euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është nuk lejohet

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



**Zyra e Kryetarit**

**Sh.02.Nr.245, datë:03.07.2025**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata Sh.02.Nr.16465 e datës 02.07.2025, nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

## **VENDIM**

**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **"Materiale digjitale për mësimdhënie"**, me numër të kontratës **KM653-25-3839-2-2-1**, si në vijim:
  - 1.1. **z. Ramadan Guda (DKA)**, CAKTOHET menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
  - 1.2 **z. Visar Dërmaku (DKA)**, CAKTOHET mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**T'i dërgohet:**

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Ramadan Guda (DKA);
- z. Visar Dërmaku (DKA); dhe
- QSHQ-arkivi.



**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



## Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.249, datë:04.07.2025|

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Afrim Dërvishi (DKA), Zyrtar Autorizues për Projektin: "Furnizim me materiale shkollore – markera dhe shpuza".**
2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtari Autorizues **z. Afrim Dërvishi**, për Projektin: **"Furnizim me materiale shkollore – markera dhe shpuza"**.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

### Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Afrim Dërvishi (DKA); dhe
- QSHQ - Arkivit.

**Kryetari i Komunës**  
  
**Kadri Rahimaj**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOS.  
QENDRA PER SHERBIM TE QYT.  
CENTAR ZA USLUGU GRAFIK  
Nr. 02  
Br. 1691  
Nr. i faq. 2  
Br. str.  
Data: 04/07  
Datum: 2025  
KAMENICE/A

Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



**Zyra e Kryetarit**

**Sh.02.Nr.247, datë 04.07.2025**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008), nenin 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 83, paragrafi 1, nënparagrafët 1.3 dhe 1.4, si dhe paragrafin 2 të Rregullores Sh.01.Nr.5300 të datës 16.02.2023 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, Kërkesës Sh.02.16157 të datës 30.06.2025, e parashtruar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe neni 70 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

### VENDIM

1. Miratohet Programi i Korrje-Shirjeve për vitin 2025 dhe njëkohësisht formohet Komisioni Komunal për zbatimin e këtij programi, me këtë përbërje:
  - 1.1. znj. Kaltrina Kryeziu (DBPZHR) - Kryesuese;
  - 1.2. z. Bektesh Dërmaku (DBPZHR) - Anëtar;
  - 1.3. z. Naser Vllasi (DSHPAIE) - Anëtar;
  - 1.4. z. Musa Ismajli (DSHPAIE) – Anëtar; dhe
  - 1.5. z. Besnik Kovani (DAP) - Anëtar.
2. Sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi, anëtarët e Komisionit janë përgjegjës për realizimin e detyrave të mëposhtme:
  - 2.1. Të bëjnë pranimin teknik të autokombajnave (makinave shirëse) dhe të japin pëlqimin për funksionimin e tyre;
  - 2.2. Të përcjellin procesin e korrje-shirjes, nga fillimi deri në përfundim;
  - 2.3. Të sigurohen se procesi i korrjeve zhvillohet në përputhje me rregulloren komunale në fuqi;
  - 2.4. Të kujdesen për respektimin e rendit të korrjes, parandalimin e derdhjes së drithit gjatë korrje-shirjes, si dhe të ndërmarrin masa mbrojtëse për parandalimin e zjarreve, duke përfshirë edhe ndalimin e ndezjes së hamulloreve;
  - 2.5. Të sigurojnë respektimin e çmimit të përcaktuar për korrje-shirje.
3. Qëllimi i formimit të Komisionit Komunal është që të përcillet dhe të menaxhohet në mënyrë sa më të rregullt, të sigurt dhe efikase procesi i korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Kamenicës për vitin 2025.
4. Komisioni mban përgjegjësi për zbatimin e këtij Vendimi, dhe për punën e vet i raporton Kryetarit të Komunës, i cili mbikëqyr zbatimin e këtij Vendimi.

5. Mandati i Komisionit Komunal vazhdon deri në përfundimin e plotë të procesit të korrjes shirjeve për vitin 2025, përfshirë të gjitha veprimet dhe raportimet e nevojshme për zbatimin e programit.
6. Vendimit i bashkangjitet Kërkesa Sh.02.16157 të datës 30.06.2025 e parashtruar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***Me këtë Vendim njoftohen:***

- Zyra e Kryetarit;
- Zyra e Informimit;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe
- QSHQ – Arkivi.

  
**Kryetari i Komunës**  
**Kadri Rahimj**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



**Zyra e Kryetarit**

**Sh.02 Nr.248, datë: 04.07.2025**

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20/2016); Vendimit Sh.02.Nr.2210, të datës 28.01.2025, për formimin e Komisionit me mandat (2) dy vjeçar për shqyrtimin e kërkesave individuale për ndarjen e subvencioneve në fushën e Zhvillimit Ekonomik, si dhe nenit 70, paragrafi 70.1, të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

## **VENDIM**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Sh.02.Nr.2210, të datës 28.01.2025, për formimin e Komisionit me mandat (2) dyvjeçar për shqyrtimin e kërkesave individuale për ndarjen e subvencioneve në fushën e Zhvillimit Ekonomik**


1. Paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Vendimit Sh.02.Nr.2210, të datës 28.01.2025, për formimin e Komisionit me mandat dyvjeçar për shqyrtimin e kërkesave individuale për ndarjen e subvencioneve në fushën e Zhvillimit Ekonomik, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Në vend të Kryesueses së Komisionit, **znj. Qëndresa Kastrati (DZHED)**, caktohet anëtare e re në Komision **znj. Nevzadije Shala (DBPZHR)**, dhe përbërja e Komisionit riformulohet si më poshtë:

- 1.1. Edon Dërmaku (DZHED), Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Liridon Rexhepaj (ZK), anëtar;
- 1.3. Arben Hoxha (DBF), anëtar;
- 1.4. Nevzadije Shala (DBPZHR), anëtare;
- 1.5. Lavdim Klaiqi (Shoqëria Civile), anëtar;
- 1.6. Zijadin Thaqi (ZK), anëtar reserve në Komision në rast konflikti të interes nga anëtarët tjerë.

2. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë Sh.02.Nr.2210, të datës 28.01.2025, për formimin e Komisionit me mandat (2) dy vjeçar për shqyrtimin e kërkesave individuale për ndarjen e subvencioneve në fushën e Zhvillimit Ekonomik.

3. Këtij vendimi i bashkëngjitet kopja e Vendimit bazë Sh.02.Nr.2210, të datës 28.01.2025, për formimin e Komisionit me mandat (2) dy vjeçar për shqyrtimin e kërkesave individuale për ndarjen e subvencioneve në fushën e Zhvillimit Ekonomik.
4. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Me vendim të njoftohet:** Zyra e Kryetarit, Zyra e Informimit, znj. Qëndresa Kastrati (DZHED), znj. Nevzadije Shala (DBPZHR), Anëtarëve të Komisionit sipas Vendimit Sh.02.Nr.2210, të datës 28.01.2025 dhe Q.SH.Q - arkivit.

  
**Kryetari i Komunës**  
**Kadri Rahimaj**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality

## Zyra e Kryetarit

**Sh.02.Nr.253, datë:09.07.2025**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

## V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Ahmet Syla (QKMF), Zyrtar Autorizues për Projektin: “Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal, material laboratorik, reagensa, si dhe furnizim me material stomatologjik”.**
2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtari Autorizues **z. Ahmet Syla**, për Projektin: **“Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal, material laboratorik, reagensa, si dhe furnizim me material stomatologjik”.**
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

### *Vendimi t'i dërgohet:*

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Ahmet Syla (QKMF); dhe
- QSHQ - Arkivit.



**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



## Zyra e Kryetarit

**Sh.02.Nr.252, datë:08.07.2025**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

## V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Blerim Murina** (Drejtoria për Investime Kapitale), Zyrtar Autorizues për Projektin: **“Asfaltimi i rrugëve lokale në Kamenicë dhe në fshatrat Ruboc, Berivojcë, Busavatë, Tugjec, Koretin, Topanicë, Petroc, Karaçevë e Epërme, Karaçevë e Poshtme, Novosellë, Muçivërc, Kopërnice, Shipashnicë e Epërme dhe Shipashnicë e Poshtme”**.
2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtari Autorizues **z. Blerim Murina**, për Projektin: **“Asfaltimi i rrugëve lokale në Kamenicë dhe në fshatrat Ruboc, Berivojcë, Busavatë, Tugjec, Koretin, Topanicë, Petroc, Karaçevë e Epërme, Karaçevë e Poshtme, Novosellë, Muçivërc, Kopërnice, Shipashnicë e Epërme dhe Shipashnicë e Poshtme”**.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

### Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Blerim Murina (Drejtoria për Investime Kapitale); dhe
- QSHQ - Arkivit.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality

## Zyra e Kryetarit

**Sh.02.Nr.251, datë:08.07.2025**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008), në zbatim të nenit 40 të Ligjit mbi Tregtine Brendshme nr. 2004/18, Ligjit nr. 04/L-005 për Ndryshimet dhe Plotësimet nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, si dhe nenit 70, paragrafi 70.1, të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM

### PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË MJETEVE ELEKTROAKUSTIKE NGA BIZNESET E SEKTORIT TË GASTRONOMISË PËR PERIUdhË TË CAKTUAR KOHORE

1. Lejohet përdorimi i mjeteve elektroakustike nga bizneset e sektorit të gastronomisë në territorin e Komunës, gjatë ditëve të punës deri në ora 23:00, ndërsa gjatë ditëve të fundjavës (e premte dhe e shtunë) deri në ora 24:00, në përputhje me standardet ligjore për nivelin e zhurmës dhe pa penguar qetësinë publike.
2. Ky lejim vlen vetëm për periudhën kohore deri më datën 31 gusht 2025.
3. Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, është përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e këtij vendimi dhe për ndërmarrjen e masave ndaj shkelësve të tij.
4. Zyra për Informim obligohet që, menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të njoftojë opinionin dhe subjektet afariste përmes faqes zyrtare të Komunës dhe rrjeteve sociale, me qëllim të informimit të gjerë dhe të qasshëm publik.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

### Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- DSHPAIE-së;
- Policisë së Kosovës (Stacioni Policor në Kamenicë); dhe
- QSHQ – Arkivit.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



**Zyra e Kryetarit**

**Sh.02.Nr.255, datë:10.07.2025**

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (nr.03/L-040), nenit 81 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik, nenit 70, paragrafi 70.18 i Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik i nxjerr nga KRPP-ja, Kontrata Sh.02.Nr.16605 e datës 03.07.2025, nenit 70, paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicë, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M

**Për caktimin e Menaxherit të Kontratës “Servisimi i kamionëve të Njesisë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit Kamenicë – ritenderim”**

1. **CAKTOHET** Menaxheri i kontratës me titull: **“Servisimi i kamionëve të Njesisë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit Kamenicë – ritenderim”**, me numër të kontratës **KM653-25-4986-1-3-6**, si në vijim:
2. **z. Sabri Rexha** (Brigada e Zjarrfikësve), **CAKTOHET** Menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
3. Obligohet menaxheri i kontratës që të hartoj planin e menaxhimit të kontratës, bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**T'i dërgohet:**

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Sabri Rexha (Brigada e Zjarrfikësve, Kamenicë); dhe
- QSHQ-arkivit.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOS.  
QENDRA PER SHERBIM TE OJ  
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 12383  
U. Br. 1

Komuna e Kamenicës  
Opština Kamenica  
Kamenica Municipality



**Zyra e Kryetarit**

**Sh.02 Nr.254, datë: 10.07.2025**

Nr. i faq. 1 Data: 10/07/2025  
Br. str. Datum: 2025  
KAMENICE/A

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20/2016), Vendimit Sh.02.Nr.16285, të datës 01.07.2025, për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "Mirëmbajtja e terreneve të hapura dhe të mbyllura sportive dhe furnizimi me rekuizita sportive", me numër identifikues të prokurimit: KM653-25-3613-2-2-1, si dhe nenit 70, paragrafi 70.1, të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Sh.02.Nr.16285 të datës 01.07.2025 për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "Mirëmbajtja e terreneve të hapura dhe të mbyllura sportive dhe furnizimi me rekuizita sportive" me numër identifikues të prokurimit: KM653-25-3613-2-2-1**

- Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.1 (një pikë një) i Vendimit Sh.02.Nr.16285, të datës 01.07.2025, për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "Mirëmbajtja e terreneve të hapura dhe të mbyllura sportive dhe furnizimi me rekuizita sportive", me numër identifikues të prokurimit: **KM653-25-3613-2-2-1**.
  - Paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.1 (një pikë një) i Vendimit Sh.02.Nr.16285, të datës 01.07.2025, për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "Mirëmbajtja e terreneve të hapura dhe të mbyllura sportive dhe furnizimi me rekuizita sportive", me numër identifikues të prokurimit: **KM653-25-3613-2-2-1**, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Në vend të Kryesuesit të Ekipës Menaxhuese, **z. Besart Fejzullahu** (DUPH), caktohet Kryesuese në Ekipën Menaxhuese **znj. Vjollcë Kryeziu** (Drejtoria e Investimeve Kapitale).
- Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë Sh.02.Nr.16285, të datës 01.07.2025, për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "Mirëmbajtja e terreneve të hapura dhe të mbyllura sportive dhe furnizimi me rekuizita sportive", me numër identifikues të prokurimit: KM653-25-3613-2-2-1.
- Këtij vendimi i bashkëngjitet kopja e Vendimit bazë Sh.02.Nr.16285, të datës 01.07.2025, për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "Mirëmbajtja e terreneve të hapura dhe të mbyllura sportive dhe furnizimi me rekuizita sportive", me numër identifikues të prokurimit: KM653-25-3613-2-2-1.
- Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Me vendim të njoftohet:** Zyra e Kryetarit, Zyra e Informimit, z. Besart Fejzullahu (DUPH), znj. Vjollcë Kryeziu (Drejtoria e Investimeve Kapitale), Anëtarëve të Ekipës Menaxhuese sipas Vendimit Sh.02.Nr.16285 të datës 01.07.2025 dhe Q.SH.Q - arkivit.



**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E KAMENICËS  
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOS.  
QENDRA PËR SHËRBIM TE QYT.  
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 17406  
U. Br.

Nr. i faq. 1 Data: 10/07  
Br. str. Datum:  
KAMENICE/A. 2025

RN00018134

Nr. 211/2025

Datë: 10.07.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Konkursi RN00018134, me numër 02/16478, të datës 02.07.2025, pozita e punës: Zyrtar Administrativ, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Anullohet Konkursi RN00018134, me numër 02/16478, të datës 02.07.2025, pozita e punës: Zyrtar Administrativ në IP.
2. Anulimi i Konkursit nga pika (1), e këtij vendimi bëhet për shkak të gabimeve teknike në shpallje.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, e cila do të bëjë rishpalljen e konkursit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendimi t'i dërgohet:**

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës e Personelit (NjMBNj);
- SIMBNJ;
- Arkivit.



**Kadri RAHIMAJ**

Kryetar i Komunës së Kamenicës



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOV  
QENDRA PER SHERBIM TE QYTETARE  
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 17500  
U. Br.

Nr. i faq. 1 Data: 11/07  
Br. str. Datum: 2025

KAMENICE/

Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



**Zyra e Kryetarit**

**Sh.02 Nr.256, datë: 10.07.2025**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008), nenin 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

## V E N D I M

### PËR LEJIMIN E PAGESËS NË VLERË PREJ 21.60 €

1. Lejohet pagesa e faturës nr. 24/2025, të datës 08.07.2025, në shumë prej 21.60 €, për shpenzimet e krijuara në Restaurant “OXYGEN” – Madhrim Krasniqi B.I në Karaçevë të Epërme. Fatura paraqet shpenzimet për pije, të shërbyera gjatë dëgjimit buxhetor me grupin e grave në Karaçevë, në kuadër të hartimit të Projekt-Buxhetit Komunal 2026–2028.
2. Pagesa të realizohet nga kodi buxhetor 16929, për Çështje Gjinore, në llogarinë bankare të dhënë në faturën e bashkangjitur si shtojcë e këtij vendimi.
3. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në Kamenicë në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.
5. Vendimit i bashkëngjitet fatura Nr. 24/2025, datë 08.07.2025, në shumën prej 21.60 €, lista e pjesëmarrësve të qytetarëve në dëgjimin buxhetor, si dhe fotografi nga aktiviteti.

#### **Vendim t'i dërgohet:**

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- DBF-së; dhe
- QSHQ – Arkivit.

Kryetar i Komunës  
**Kadri Rahimaj**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOS.  
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY  
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 17709  
U. Br.  
Nr. i faq. 2 Data: 14/07  
Br. str. KAMENICE/ 2025

Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



**Zyra e Kryetarit**

**Sh.02.Nr.258, datë:11.07.2025**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20/2016), neni 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Blerim Murina** (Drejtorja për Investime Kapitale), Zyrtar Autorizues për Projektin: **"LOT 1: Asfaltimi i rrugëve në Busavatë, Ruboc, Kamenicë, Tugjec, Petroc, Koretin, Topanicë, Berivojcë dhe Krilevë, LOT 2: Asfaltimi i rrugëve në Karaçevë të Epërme, Karaçevë të Poshtme, Novosellë, Muçivërc, Kopërnice, Shipashnicë e Epërme, Shipashnicë e Poshtme, Hodonoc dhe Roganë"**.
2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtari Autorizues **z. Blerim Murina**, për Projektin: **"LOT 1: Asfaltimi i rrugëve në Busavatë, Ruboc, Kamenicë, Tugjec, Petroc, Koretin, Topanicë, Berivojcë dhe Krilevë, LOT 2: Asfaltimi i rrugëve në Karaçevë të Epërme, Karaçevë të Poshtme, Novosellë, Muçivërc, Kopërnice, Shipashnicë e Epërme, Shipashnicë e Poshtme, Hodonoc dhe Roganë"**.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi *shfuqizohet* Vendimi Sh.02.Nr.17166 i datës 09.07.2025.
6. Bashkëngjitur këtij vendimi janë kopja e Vendimit Sh.02.Nr.17166 i datës 09.07.2025.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet:***


- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Blerim Murina (Drejtoria për Investime Kapitale); dhe
- QSHQ - Arkivit.

**Kryetari i Komunës**  
  
**Kadri Rahimaj**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



## Zyra e Kryetarit

**Sh.02 Nr.257, datë: 11.07.2025**

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20/2016), Vendimit Sh.02.Nr.34456, të datës 29.10.2024, për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "Ndërtimi i Urës në fshatin Hodonoc", me numër identifikues të prokurimit: KM653-25-3613-2-2-1, si dhe nenit 70, paragrafi 70.1, të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

### VENDIM

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Sh.02.Nr.34456 të datës 29.10.2024 për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "Ndërtimi i Urës në fshatin Hodonoc", me numër identifikues të prokurimit: KM653-25-3613-2-2-1**

- Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.1 (një pikë një) i Vendimit Sh.02.Nr.34456, të datës 29.10.2024, për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "Ndërtimi i Urës në fshatin Hodonoc", me numër identifikues të prokurimit: **KM653-25-3613-2-2-1**.
